



Drejtori Xhemaledin Nexhipi është shumë i dashur tek banorët dhe i respektuar në mesin e të punësuarve. Ky person i ri, i aftë dhe ambicioz, i cili shumicës së banorëve sipas viteve mund t'u jetë nip, tregon se prej nga vijnë ndryshimet në këtë institucion

Shtëpia e pleqve "Zafir Sajto" në Kumanovë çdo ditë e më shumë po i përngjanë një shtëpie të vërtetë në të cilën i kalon ditët e saj familja më e madhe në Kumanovë, e përbërë nga banorët më të moshuar të qytetit dhe vendbanimeve fqinje. Për hir të së vërtetës, më herët nuk ka qenë kështu, me siguri për shkaqe objektive, por edhe për shkaqe të tjera. Drejtori Xhemaledin Nexhipi është shumë i dashur tek banorët dhe i respektuar në mesin e të punësuarve. Ky person i ri, i aftë dhe ambicioz, i cili shumicës së banorëve sipas viteve mund t'u jetë nip, tregon se prej nga vijnë ndryshimet në këtë institucion. "Kur erdha në këtë funksion u ballafaqova me një fotografi, mund të thuhet, jo të bukur dhe të dhimbshme. Siç kalonte koha, dëshpërimin tim fillestar e shtypa dhe i munda me punë, ide dhe gjetje të mënyrës se si të ndryshojnë kushtet e këqija ku jetonin këta njerëz, të cilët kishin nevojë për kujdes, por edhe krevat të ngrohtë, si dhe trajtim përkatës. Hap pas hapi, ditë pas dite, puna jepte rezultate, që më inkurajonte të vazhdoj rrugës kah jam nisur. Po ashtu duhet të pranoj se në atë më ka ndihmuar dhe më ka dhënë mbështetje i tërë personeli i punësuar në shtëpi.

Sot me krenari mund të them se kushtet jetësore të banorëve janë shumë më të mira se dikur. Puna jonë me përgjegjësi ka kontribuar që të realizojmë shumë gjëra të cilat i kemi shënuar si prioritare. Përkushtimet dhe ndryshimet

Shembull për punë me përgjegjësi

Përkushtimi në punë, gjithmonë jep rezultate



kanë vazhduar edhe gjatë këtij viti. Para se të arrijë dimri kemi bërë ndryshimin e të gjitha dritareve të shtëpisë. Kjo do të kontribuojë që banorët të kenë më ngrohtë, por edhe ndërtesa të ketë efikasitet energjetik, gjë që do të sjell deri tek kursimi i mjeteve të caktuara financiare, të cilat do ti investojmë në realizimin e punëve të ndryshme. Ndërrimi i dritareve së bashku me roletnet e reja na ka kushtuar 2 300 000 denarë mjete personale. Ka filluar edhe ndërrimi i pllakave në hapësirat sanitare dhe ndërrimi i tepisonit me laminat nëpër korridore. Për këtë do të shpenzohen rreth 1 200 000 denarë, gjithashtu mjete personale. Në procedurë është edhe tenderi për furnizim të mobileve, tavolinave, ormanëve dhe gjërave të tjera, për të ndërruar të vjetrat, që gjenden në dhomat e banorëve. Kuptohet

se ka edhe shumë punë që duhet të bëhen, por rezultatet dhe ndryshimet janë të limituara me mundësitë, por me punë të përgjegjshme arrihet mjaft. Krahas këtyre kontributeve në shtëpi mbajmë llogari edhe për ushqimin e banorëve, për shëndetin e tyre dhe si t'ua bëjmë ditën të mbushur me përmbajtje dhe evenimente të ndryshme. Me spitalin e qytetit në Kumanovë kemi lidhur marrëveshje dhe çdo vit vjen mjeku internist dhe neuropsikiatër sepse për ata është nevoja më e madhe për shkak të sëmundjeve kronike nga të cilat vuajnë banorët tanë. Gjithashtu, organizohen ekskursione, vizita, shëtitje, punëtori dhe gjëra të tjera. Edhe unë edhe punëtorët në shtëpi angazhohemi maksimalisht edhe pse nuk e kemi punën e lehtë, por shpërbllim për ne është kënaqësia dhe

falënderimi të cilën e shohim në sytë e këtyre njerëzve, të cilët gjithashtu nuk e kanë lehtë sepse janë të detyruar që shtëpinë e tyre personale ta zëvendësojnë me jetë në institucion. Interesant është fakti se çdo ditë e më pak është "turp" që prindi të dërgohet në shtëpi pleqsh. Kohët po ndryshojnë, po ndryshon tradita dhe mënyra e jetesës. Shtëpia e pleqve po bëhet një prej alternativave më të mira tek të gjitha nacionalitetet. Në shtëpi kemi edhe dy shqiptarë, diçka që ishte e paimagjinueshme para pesë gjashtë viteve. Megjithatë, duhet të ndërtohen edhe më shumë shtëpi sepse për disa vite sikur kjo çështje të ishte në plan të dytë. Për fat të mirë punët po ndryshojnë në të gjitha nivelet. Kjo është shumë me rëndësi sepse banorët plakët si tek ne ashtu edhe në botë.

Shoqata e pensionistëve të Tetovës Çdoherë të parët, ose në krye

Për rezultatet e këtyra të gjithë pensionistët – sportistë janë meritator, megjithatë duhet ta veçojmë angazhimin e tash më të ndjerit Faik Jashari, i cili pesëmbëdhjetë vjet ishte kryetar i Komisionit për aktivitete sportive të SHP Tetovës

Prej themelimit në vitin 1996 e deri në garat sportive republikane jubilarë të Maqedonisë për këtë vit, sportistët-pensionistë nga Tetova çdoherë kanë zënë vendin e parë, ose janë plasuar në mesin e pesë ekipeve të para. Në të gjitha garat e deritanishme rajonale ata vazhdimisht janë radhitur në pozitën e parë në radhën e përgjithshme. Për rezultatet e këtyra të gjithë pensionistët – sportistë janë meritator, megjithatë duhet ta veçojmë angazhimin e tash më të ndjerit Faik Jashari, i cili pesëmbëdhjetë vjet ishte kryetar i Komisionit për aktivitete sportive të SHP Tetovës, ndërsa në të gjitha garat rajonale dhe republikane në disiplinat shah, në mënyrë të suksesshme ka kryer detyrën e referit.

Retrospektiva e sukseseve të SHP Tetovës, të orienton në konstatim se nga 20 garat e mbajtura sportive republikane, dy vitet e para nuk janë shpallur fitues të përgjithshëm. Për herë të parë kjo është bërë në vitin 1998, që kur është themeluar vazhdimësia dhe në të cilën periudhë tetë herë pensionistët e Tetovës janë stolitur me kupën e fituesit, ndërsa për tre vite me radhë kanë mbajtur vendin e parë në vitet 2002, 2003 dhe 2004, dhe kështu kupa ju kalua në pronësi të përhershme. Një "privilegj" i këtyrë deri tani i ka takuar edhe SHP Ohër dhe Debërcë. SHP Tetovë është iniciator për garat sportive të pensionistëve, së bashku me disa shoqata tjera në vend. U tregua se organizimi i këtyrë paraqet jo vetëm popullaritet të sportit mes njerëzve të "gjeneratës së tretë", por në këtë mënyrë pensionistët edhe shoqërohen, mbajnë vitalitetin e tyre, vazhdojnë frymën për të garantuar dhe për plasman të lartë dhe përcaktimi themelor: të marrësh pjesë, por nuk do të thotë që çdoherë të fitohet. Për përgjegjësinë në SHP Tetovë e dhënë e rëndësishme është edhe pjesëmarrja masovike në këto lojra sportive. Përzgjedhja e parë është në kuadër të degëve, ndërsa pastaj me më të mirët organizohen përgatitjet, të cilët varësisht nga disiplina, zgjasin në mënyra të ndryshme. Megjithatë, konsiderohet se ndërrimi i fundit i pensionistëve – sportistë, kryesisht për shkak të moshës në katër-pesë vitet e fundit, nuk arrihen rezultatet më të larta dhe në këtë periudhë vendi i parë në plasmanin e përgjithshëm në garat republikane "i është lënë" shoqatave të tjera. Është fakt se inkuadrohet nga ndonjë garues i ri, por gjithashtu është fakt edhe ajo se ekipi i pensionistëve sportistë të Tetovës merr pjesë me përbërje të përzier nacionale. Mundësi është të themi se në të gjitha këto suksese, i theksuar është ndikimi i Faik Jasharit të ndjerit para disa kohëve, i cili mbi 25 vjet ishte një ndër më aktivët në SHP Tetovë, si dhe pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë Hristofor Todorov, Jordan Paunovski, Vinko Smilevski, Jablanka Veselinovska, Liljana Avramovska, Genc Kuriu, Abdulrezak Rustemi, Mitko Bogatinovski dhe shumë të tjerë.

Plaketa nga LSHPM për ligjvënësin dhe ekzekutivin

Me rastin e 70 vjetorit nga organizimi i pensionistëve në vendin tonë, kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Trajko Veljanovski ka pranuar kryetarin e Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, Dragi Argirovski dhe kryetarin e Këshillit ekzekutiv të LSHPM Saltir Karovski. Gjatë kësaj kryetari Argirovski në mënyrë solemne i dhuroi Plaketë nga LSHPM kryetarit Veljanovski për kontributin e veçantë të Kuvendit në zhvillimin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni. Kryetari Argirovski në fjalimin e tij gjatë takimit theksoi se Lidhja në mënyrë të suksesshme dhe me dinjitet ka shënuar jubileun e madh – 70 vjetorin e organizimit të pensionistëve në Maqedoni me sërë manifestimesh, ndërsa theks të veçantë i dha kontinuitetit historik dhe arritjeve gjatë viteve të fundit kur Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë u bë shembull dhe lider i veprimtarisë së pensionistëve në rrethinë dhe më gjerë në mesin e vendeve të Ballkanit. Duke iu falënderuar për mirënjohjen, kryetari i Kuvendit të RM Veljanovski theksoi rëndësinë e punës në



këtë organizatë më masovike dhe shumë aktive joqeveritare multietnike dhe u dëshiroi suksese dhe arritje të reja të gjithë pensionistëve në vendin tonë. Gjithashtu, Kryeministri i Republikës së Maqedonisë, Emil Dimitriev më 25 tetor 2016 ka pranuar një delegacion nga LSHPM të udhëhequr nga kryetari i LSHPM Dragi Argirovski. Në delegacion ishin kryetari i Kuvendit Besnik Poca, sekretari i KE Stanka Trajkova dhe anëtarët e KE Kalina S. Andonova dhe Gjorgji Serafimov. Shkaku i vizitës ishte të dhuroarit e pllaketës nga LSHPM për Qeverinë e RM, me rastin e jubileut të madh, 70 vjetori i organizimit të pensionistëve në Maqedoni dhe për të infor-

muar Kryeministrin Dimitriev me aktivitetet dhe arritjet e LSHPM gjatë shtatë dekadave të kaluara, me theks të veçantë të dekadës më aktive të fundit, në të cilën LSHPM shënon rezultate të qarta të paarrishme për asociacionet e pensionistëve në rrethinë dhe më gjerë të Ballkanit. Në takim kryetari i LSHPM Argirovski zyrtarisht i dhuroi Plaketën Kryeministrin Dimitriev, dhe pas asaj ai theksoi, "Rruga drejtë së cilës shkojmë është rruga e së vërtetës, nderit dhe bashkëjetesës. Ashtu është deri tani, ndërsa ashtu do të vazhdojmë dhe në atë jemi të bindur edhe në Lidhje edhe në të gjitha 53 shoqatat vullnetarisht të bashkuar me qëllim të njëjtë. E falënderojmë

shoqërinë që nuk na le në margjinat ndodhive në vendin tonë dhe kujdeset për ne". Kryeministri Dimitriev u falënderua për nderin që ia bëjnë banorët më të moshuar të vendit me ndarjen e Plaketës me rastin e 70 vjetorit të organizimit të pensionistëve në Maqedoni dhe mes tjerash tha, "Kam nderin e veçantë që jeni mysafirët e mi. Qeveria edhe deri tani edhe në të ardhmen do të mbështesë pensionistët dhe do të shqyrtojë të gjitha propozimet dhe vërejtjet që janë në interes të pensionistëve dhe në interes të shtetit, në kufi të mundësive. Kuptohet, çdoherë mund dhe duhet të jetë më mirë dhe më shumë".